

INDUSTRIA
NXJERRËSE
NË SHQIPËRI



ALBEITI

RAPORTI I PROGRESIT VJETOR 2023

Tiranë 2024



Përmbajtja

❖	VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I PERFORMANCËS PËR VITIN 2023	3
❖	AKTIVITETE KOMUNIKIMI	5
❖	VLERËSIM I PERFORMANCËS KUNDREJT KËRKESAVE EITI	7
❖	VEPRIMTARIA E ALBEITI NË KUADËR TË REALIZMIT TË RAPORTEVE EITI	18
❖	NDONJË PIKË E FORTË OSE DOBËSITË E IDENTIFIKUAR NË PROCESIN EITI	21
❖	PUBLIKIMI I PRONARËVE PËRFITUES	21
❖	KOSTOJA TOTALE E IMPLEMENTIMIT	22
❖	DETAJET E ANËTARËSISË DHE TAKIMET E MSG-SË GJATË VITIT 2022	23

❖ VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I PERFORMANCËS PËR VITIN 2023

Raporti i Progresit Vjetor EITI për vitin 2023 të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, EITI Shqipëri, i cili paraqet një përmbledhje të aktiviteteve të Grupit Ndërinstitucional të Punës (MSG) dhe Sekretariatit Kombëtar EITI.

Projekti kryesor i Grupit Ndërinstitucional të Punës (MSG) dhe Sekretariatit Kombëtar EITI ishte realizimi brenda vitit 2022 i Raporteve EITI për vitet 2019, 2020 dhe 2021, i cili nuk u bë i mundur për shkak të mungesës së fondeve. Por gjithsesi në bashkëpunim me Sekretariatin Ndërkombëtar EITI Oslo dhe përfaqësuesit e Bankës Botërore në këtë drejtim është punuar për rishikim e ToRs të këtij aktiviteti duke i finalizuar sipas modelit për raportim fleksibël.

Grupi Ndërinstitucional i Punës (MSG) ka rishikuar dhe ka miratuar planin e tij të punës për vitet 2022 – 2023 në datën 06.05.2022. Ky plan pune formoi bazën e aktiviteteve të cilat ishin parashikuar për vitin 2023 (kërkesa 7.4(a)(iv)).

<https://www.albeiti.org/site/publikime/>

- Lista e objektivave dhe qëllimet e përcaktuara në planin e punës, dhe përparimi në arritjen e tyre:

Aktiviteti/Kërkesa sipas Standardit EITI	Statusi
• Plani i Punës 2022- 2023, <i>Kërkesa 1.5</i>	Përfunduar
• Raporti i Progresit Vjetor 2022-2023, <i>Kërkesa 7.4</i>	Përfunduar
• Ndjekja e gjetjeve dhe rekomandimeve të raporteve të EITI për vitet 2017-2018 dhe Validimi III i Shqipërisë <i>Kërkesa 7.3</i>	Në vijim
• Aktivitetet e Komunikimit për 2022- 2023 <i>Kërkesa 7.4, 1.2, 1.3</i> <i>(Sqarim: Aktivitete e komunikimit kanë filluar në fund të vitit 2023 dhe do vijojnë dhe në vitin 2024)</i>	Në vijim
• Raportet EITI 2019, 2020 dhe 2021 <i>Kërkesa 4.8</i>	Në vijim
• Veprimet Korrigjuese nga Validimi i III i Shqipërisë	Në vijim

❖ AKTIVITETE KOMUNIKIMI

24 Janar 2023 Me ftesë të Sekretariatit Ndërkombëtar për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), Sekretariati Kombëtar për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (ALBEITI) zhvilloi një vizitë 6 ditore gjatë muajit janar 2023 në Oslo, ku përfaqësuesit e institucionit morën pjesë në një mori takimesh intensive me qëllim ngritjen e kapaciteteve institucionale si dhe zgjerimin e bashkëpunimit në të ardhmen.

Objekti i këtyre takimeve ishte konsolidimi i kontributit të dhënë nga Shqipëria lidhur me transparencën në industrinë nxjerrëse si edhe njohja, diskutimi i praktikave të punës konform Standardit EITI, analiza e punës që është bërë nga ana e Sekretariatit Kombëtar EITI deri tani dhe mënyrat e përmirësimit akoma më shumë në të ardhmen.

Përfaqësuesit e Sekretariatit gjatë ditëve të qëndrimit, duke u bazuar në axhendën e dakordësuar paraprakisht mbi çështjet që do të trajtoheshin, pati shumë takime dhe diskutime me përfaqësues të Sekretariatit Ndërkombëtar EITI për çështje që lidheshin me punën dhe impaktin e Nismës EITI globalisht, por edhe për punën e bërë nga Shqipëria në implementimin e kësaj nisme. Shqipëria në procesin e Validimit të realizuar gjatë vitit 2021 pati një performancë të shumë vlerësuar nga ana e Sekretariatit Ndërkombëtar EITI, duke theksuar se është ndër të paktat vende anëtare në Standardin EITI që ka kryesuar në procesin e validimit. Gjithashtu nga ana e përfaqësuesve të Sekretariatit Ndërkombëtar u theksua se procesi i Validimit të Shqipërisë, e cila ishte një nga vendet e para që u validua me Standardin EITI 2019, konsiderohet si një nga proceset më të mira, si nga koordinimi i procesit, por edhe nga angazhimi i palëve të interesuara.

Duke qenë se Shqipëria është vendi lider për raportimin EITI të Hidroenergjisë, Drejtuesit të Sekretariatit Z. Genci Tërpo ju kërkua të bënte një prezantim të Sektorit, të kuadrit ligjor dhe të qasjes së Shqipërisë në fillimet e raportimit për Hidroenergjinë. Ai theksoi në prezantim se EITI mund të jetë një mjet për qeveritë që kërkojnë të forcojnë përgjegjshmërinë dhe mbikëqyrjen publike të sektorit të tyre në zhvillim të burimeve të rinovueshme. Raportimi EITI në Shqipëri shkon përtej Standardit EITI dhe Shqipëria është i vetmi vend EITI duke ofruar informacion mbi sektorin e rëndësishëm të hidroenergjisë në vend, duke përfshirë kuadrin ligjor dhe rregullator, shifrat e prodhimit, të ardhurat e qeverisë dhe shpërndarjen e të ardhurave për autoritetet vendore. Pikërisht raportimi sipas standartit EITI ka bërë që Shqipëria të ndihmojë në informimin dhe vendimmarrjen si dhe krijimin e një mjedisi tërheqës investimi, ndërsa vendi kërkon të zhvillojë më tej sektorin e tij të burimeve të rinovueshme dhe është një ndër objektivat themelore të Qeverisë dhe të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në vijim. Nga ana e pjesëmarrësve në këtë prezantim pati interes të madh për eksperiencën e Shqipërisë duke qenë se tashmë po punohet që Energjitë e Rinovueshme, përfshirë këtu Hidroenergjinë, të bëhen pjesë e Standardit EITI dhe e raportimit, ndërkohë që Shqipëria prej Raportit EITI për vitin 2015 raporton për Hidroenergjinë, pra eksperiencën e Shqipërisë tashmë konsiderohet shumë e vlefshme për të gjitha vendet anëtare të EITI-t, të cilat janë duke hedhur hapat e para në këtë drejtim.



28 Shkurt 2023 Drejtuesi i Sekretariatit Kombëtar për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (Albeiti), Z. Genci Tërpo, ka marrë pjesë në mbledhjen e konstituimit të vendeve implementuese EITI gjatë zhvillimit të punimeve në mbledhjen e 55-të të Bordit Ndërkombëtar EITI në Buenos Aires (Argjentinë). Në këtë takim po diskutohet për çështje që lidhen me ndryshimet e Standardit EITI, si dhe për ndryshimet në bordin EITI në vijim.



12 - 13 Qershor 2023 Drejtori i Albeiti, Z. Genci Tërpo, u zgjodh Anëtar zëvendësues i Bordit Ndërkombëtar të Sekretariatit EITI për një mandat 3- vjeçar, i cili është organi më i lartë vendimmarrës i Iniciativës Globale për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Z. Tërpo mori pjesë në Mbledhjen e 57-të të Bordit Ndërkombëtar gjatë punimeve në Konferencën Globale e EITI që është duke u zhvilluar në Dakar Senegal, në datat 13-14 qershor 2023. Përfaqësimi i Sekretariatit Kombëtar Albeiti në kuadrin e iniciativës EITI në nivel anëtar i bordi ndërkombëtar është për herë të parë dhe konsiderohet si një arritje mjaft e rëndësishme për Shqipërinë (<https://eiti.org/news/2023-2026-eiti-board-elected>). Bordi i EITI-t është organi kryesor vendimmarrës i EITI-t. Ai merr vendime për prioritetet e organizatës dhe vlerëson përparimin e vendeve në përmbushjen e Standardit të EITI-t.



12 - 13 Qershor 2023 Drejtori i Sekretariatit EITI në Shqipëri mori pjesë në Konferencën Globale të EITI-t e cila u zhvillua në Dakar Senegal. Konferenca kryesore globale e EITI-t mbledhi më shumë se 1,200 palë të interesuara në Dakar, Senegal, për të bërë bilancin e progresit në publikimin dhe përdorimin e të dhënave të hapura për të informuar vendimmarrjen, analizën dhe debatin publik mbi menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore.

Duke shënuar 20-vjetorin e EITI-t, konferenca festoi arritjet në transparencën e burimeve natyrore dhe dialogun shumëpalësh, ndërsa gjithashtu shikoi drejt së ardhmes për të shqyrtuar se si EITI duhet të përshtatet me peizazhin në ndryshim të energjisë dhe kërkesën në rritje për një sektor të hapur dhe të përgjegjshëm të burimeve.

<https://www.youtube.com/watch?v=amlHdPddKZs>

❖ VLERËSIM I PERFORMANCËS KUNDREJT KËRKESAVE EITI

Siç kemi përmendur më sipër gjatë vitit 2023 për shkak të mungesës së fondeve nuk ka qenë e mundur përgatitja dhe publikimi i Raporteve EITI 2019, 2020 dhe 2021, për këtë arsye në tabelën që vijon, të dhënat në lidhje me Raportin EITI vazhdojnë të jenë ato të Raporteve 2018 – 2019. Megjithatë Albeiti në vitin 2023 e filloi procesin e realizimit të raporteve EITI për tre vitet përkatëse.

KËRKESAT	PROGRESI
KËRKESA EITI 1 Mbikëqyrja nga Grupi Ndërinstitucional i Punës 1.1 Angazhimin e qeverisë 1.2 Angazhimin e kompanive 1.3 Angazhimin e shoqërisë civile 1.4 Grupi Ndërinstitucional i Punës 1.5 Plani i Punës	MSG në Shqipëri është përfshirë në mënyrë aktive në zbatimin e EITI. Anëtarët MSG janë të angazhuar në zbatimin e EITI, sipas sektorit që ata mbulojnë. Institucionet shtetërore, pjesë përbërëse e MSG, kanë treguar angazhim të lartë duke vënë në dispozicion të Iniciativës EITI strukturat dhe burimet e tyre njerëzore për të gjitha çështjet, edhe për informacione të tjera që janë kërkuar nga Sekretariati në Shërbim të Procesit. Qeveria ka vazhduar të financojë kostot administrative për vitin 2022 për zbatimin e EITI nga buxheti kombëtar. Gjetja e një gjuhe gjithëpërfshirëse dhe ndërtimi i një bashkëpunimi konstruktiv e bëjnë punën e MSG Shqipëri produktive. Anëtarët e MSG nga Shoqëria Civile kanë treguar përkushtim ndaj Nismës EITI duke qenë të zëshëm në takimet e zhvilluara online për çështje të ndryshme. Përfaqësia e SHC në MSG ka një frymë të mirë dhe të qëndrueshme. Anëtarët e SHC gjatë viti 2022, jo vetëm kanë qenë aktiv në çështjet e shtruar për diskutim, por kanë vijuar punën e tyre për përhapjen e informacionit për procesin e EITI-t në Shqipëri me anë të shkrimeve në gazeta apo postimeve dhe shpërndarjes së aktivitetit të EITI-t nëpër rrjetet sociale. MSG-ja EITI Shqipëri gjatë vitit 2022 ka zhvilluar dy Takime të online ku janë diskutuar çështje të ndryshme që kanë pasur të bëjnë me implementimin e EITI-t në Shqipëri. Gjithashtu, gjatë vitit 2022, MSG-ja ka qenë, jo vetëm pjesëmarrëse, por edhe tepër e angazhuar me komente dhe diskutime në çështjet që janë diskutuar.
KËRKESA EITI 2 Kuadri ligjor dhe institucional, duke përfshirë alokimin e kontratave dhe licencat 2.1 Kuadri ligjor dhe regjimi fiskal 2.2 Shpërndarja e liçensave 2.3 Regjistri i liçensave 2.4 Kontratat 2.5 Pronarët Përfitues	<u>Kuadri ligjor dhe regjimi fiskal</u> Alokimet e licencave. Shqipëria ka bërë publike zonat e lira të naftës dhe kompanitë e interesuara hyjnë në negociata me qeverinë shqiptare. Licencat minerare ofrohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në Ligjin Nr. 10 304 datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”. Programi vjetor minerar, miratuar me V.K.M., përcakton zonat minerare konkurruese dhe zonat e lira. Për zonat minerare konkurruese subjektet e interesuara i nënshtrohen një konkurrimi publik,

2.6 Pjesëmarrja e shtetit

ku vlerësimi i fituesit bëhet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara me ligj. Për zonat e hapura licenca i jepet subjektit të interesuar, i cili plotëson kushtet e lejit sipas parimit “i pari në kohë, i pari në të drejta”. Publikimi i Planit vjetor minerar dhe të gjitha procedurave konkurruese bëhet në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe në faqen zyrtare të MIE. Sipas raportit EITI 2017 – 2018 dhe në përputhje me kërkesat 2.4.b, Shqipëria ka bërë përparim në publikimin e **kontratave** të reja të naftës dhe të të gjitha termave të koncesionit të hidrocentraleve.

Marrëveshjet e naftës dhe gazit u ndanë përmes procedurave ad hoc të negociatave deri në gusht 2013. Informacioni mbi të licencuarit dhe operacionet e përbashkëta publikohen në faqen e internetit të MIE-së.

Ndërtimi i hidrocentraleve të reja bëhet me koncesion të tipit BOT (Ndërtim, Operim, Transferim). Fituesi i cili shpallet mbas një procedure konkurruese të hapur, e cila zhvillohet nga MIE (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) pasi është publikuar nga APP (Agjencia e Prokurimit Publik). Mbas shpalljes fitues subjekti duhet të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm përcaktuar në ligj.

Regjistri i licencave është i disponueshëm publikisht në faqen e internetit ALBEITI:

www.albeiti.org. Ky regjistër rifreskohet çdo 6 muaj. Gjithashtu Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës ka publikuar një regjistër të licencave minerare në linkun:

<http://www.infrastruktura.gov.al/lejet-minerare-ekzistuese>.

Ligji i ri 112/2020 "PËR REGJISTRIN E PRONARËVE PËRFITUES" është aprovuar në 29 Korrik 2020 dhe deklarata e pronarëve përfitues do të fillojë në Janar 2021.

Siç detyrohet nga ligji i ri, pjesëmarrja e kompanisë në publikimin e pronarëve përfitues kërkohet për të gjitha kompanitë e regjistruara në vend. Ky informacion do të jetë në dispozicion në një regjistër të administruar nga QKB.

Deri në korrik të vitit 2020 korniza ligjore parashikonte publikimin e pronarëve të drejtpërdrejtë, por jo edhe pronësinë përfituese sipas kërkesës së standardit EITI. Kompanitë e përzgjedhura si subjekte raportuese u kërkuan të japin informacion mbi pronarët përfitues.

	Pjesëmarrja e shtetit a) Subjektet shtetërore në Shqipëri përcaktohen me nenin 213 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për sipërmarrësit dhe subjektet tregtare", si subjekte tregtare të zotëruara dhe të kontrolluara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga qeveria qendrore ose qeveria lokale, kurse kontrolli fuqia për të qeverisur aktivitetet e subjekteve tregtare. Ky ligj sugjeron në rastet e çështjeve që kërkojnë shumicë të kualifikuar, Aksionerët. Përkufizimi i NSH-ve shpjegohet në Raportin EITI 2017 – 2018 dhe MSG-ja është pajtuar me këtë përkufizim gjatë procesit të raportimit EITI. b) Niveli i pronësisë së NSH-ve është shpjeguar në Raportin EITI 2017 – 2018.
KËRKESA EITI 3 Kërkim-Zbulimi dhe prodhimi 3.1 Kërkim-Zbulimi 3.2 Prodhimi 3.3 Eksportet	Të gjitha të dhënat e kërkim-zbulimit, prodhimit dhe eksportit janë të dokumentuara në Raportin e EITI Shqipëri dhe gjenden të publikuara në faqen e internetit www.albeiti.org.
KËRKESA EITI 4 Mbledhja e të ardhurave 4.1 Publikim i detajuar i taksave dhe të ardhurave 4.2 Shitja e pjesës së shtetit të prodhimit ose të ardhurave të tjera të mbledhura në natyrë 4.3 Dispozitat e infrastrukturës dhe marrëveshjet e shkëmbimit 4.4 Të ardhurat nga transporti 4.5 Transaksionet që kanë të bëjnë me ndërmarrjet shtetërore 4.6 Pagesat në nivel kombëtar 4.7 Niveli i ndarjes 4.8 Koherenca e të dhënave 4.9 Cilësia dhe siguria e të dhënave	Publikim i detajuar i taksave dhe të ardhurave Sistemi i taksave që zbatohet në Shqipëri për sektorin e industrisë nxjerrëse është e njëjtë që zbatohet për ekonominë e gjithë vendit, TVSH, tatim mbi fitimin, dividendët + renta, bonuse dhe pagesa të tjera të rëndësishme dhe përfitime materiale për qeverinë. Renta minerare nga qeveria shihet si një taksë për zhvillimin e kësaj zone. Për të dhënë impuls ose zhvillim në industrinë e përpunimit në vend, qeveria uli rentën për kromit e përpunuar (ferrochrome) nga 6 në 3 për qind. Raporti i EITI tregon një përmbledhje gjithëpërfshirëse tatimore të mbledhur nga qeveria për vitin 2017- 2018. Shitja e pjesës së shtetit të prodhimit ose të ardhurave të tjera të mbledhura në natyrë Në Raportin EITI 2017- 2018 janë shpalosur të hyrat e mbledhura në natyrë nga Albpetrol. Marrëveshjet për Sigurimin e Infrastrukturës Raporti i EITI 2017- 2018 përfshin një vlerësim të zbatueshmërisë së dispozitave të infrastrukturës dhe aranzhimeve të këmbimit në sektorët e naftës dhe minierave, të përshkruara respektivisht në kapitullin 3 dhe 4. Të ardhurat nga transporti Shteti Shqiptar nuk merr taksë tranziti. Tubacionet e Albpetrol nuk janë funksionale. Dy tubacione për transportin e naftës së papërpunuar

lidhin terminalin e naftës së ARMOs në Vlorë me rafineritë e Fierit dhe Ballshit si dhe dy rafineritë mes tyre. Të dy tubacionet janë jashtë funksionit për shkak të amortizimit të plotë. Në total, rrjeti i tubacioneve të naftës ka një gjatësi prej 188 km dhe kapacitet prej 2.5 milion ton në vit.

Trans Adriatic Pipeline (TAP) AG është një bashkim i disa shoqërive ndërkombëtare themeluar me qëllim planifikimin, zhvillimin dhe ndërtimin e gazsjellësit. Aktualisht ka përfunduar ndërtimi i tubacioneve dhe vazhdon ndërtimi i stacioneve të pompimit dhe të shpërndarjes. Sipas marrëveshjes të lidhur midis TAP dhe Qeverisë Shqiptare, TAP investoi rreth 14 milionë euro në infrastrukturë dhe investime të tjera në dobi të shoqërisë civile dhe komuniteteve.

Jonian Adriatic Pipeline (Projekti IAP)

Qeveria Shqiptare ka promovuar mundësinë e realizimit të projektit Adriatic Pipeline (IAP), me qëllim që të krijojë Infrastrukturën e përbashkët Rajonale për të shfrytëzuar gazin Kaspik në tregjet e vendeve si Shqipëria, Mali i Zi, Kroacia

Infrastruktura e gazit në Shqipëri

Qeveria Shqiptare miratoi ligjin për sektorin e gazit natyror Nr.102 / 2015 “Për sektorin e gazit” në mars të vitit 2015. Ky ligj do të qeverisë zhvillimin e infrastrukturës për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit në Shqipëri.

Në vitin 2016, Qeveria themeloi Operatorin Shqiptar të Transmetimit të Gazit (Albgaz Sh.a.) dhe prezantoi draft master-planin për rrjetin e shpërndarjes së gazit. Ky studim kushtoi rreth 1.1 milion euro dhe u financua nga BE.

Drafti i master-planit analizon përdorimin e gazit në industri, transport dhe konsumatorët familjarë etj. TAP do të jetë burimi kryesor i furnizimit me gaz, ndjekur nga Jonian-Adriatic Pipeline (IAP) dhe rezerva të tjera potenciale të vendit. Drafti konsideron mundësinë e lidhjes së Kosovës dhe Maqedonisë me rrjetin Shqiptar të shpërndarjes së gazit. Gjithashtu, plani konsideron dhe mundësinë e depozitimit të gazit në nëntokën e Divjakës, në Dumre.

Sipas studimit, konsumi vendas i gazit parashikohet të jetë rreth 2,167 milion m³ në vitin 2040 (duke përfshirë bujqësinë dhe transportin). Në të njëjtin vit, përdorimi potencial i gazit për prodhimin e energjisë elektrike vlerësohet të jetë rreth 770 milion m³, ndërsa përdorimi potencial i gazit në proceset e rafinerimit të naftës

	parashikohet të jetë 89 milion m3. Transaksionet që kanë të bëjnë me ndërmarrjet shtetërore Albpetrol i paguan taksa qeverisë, siç zbatohet për të gjitha kompanitë komerciale të naftës dhe dividendët në cilësinë e aksionarit të vetëm të kompanisë. Të dy Albpetrol dhe MIE njoftuan se nuk ka marrëveshje të posaçme që rregullojnë transferimet nga Albpetrol në Qeveri dhe anasjelltas. Albpetrol ka qenë fitimprurës deri më tani, pavarësisht bazës së madhe të kostos së punonjësve. Financat e Albpetrol tregojnë rezultate të luhatshme të fitimit. Të ardhurat rrjedhin kryesisht nga shitja e naftës në dispozicion. Albpetrol nuk ka marrë, as nuk ka dhënë hua për Qeverinë deri tani. Pagesat lokale Renta mblidhet nga shitjet e tatueshme të naftës, gazit dhe mineraleve dhe regjistrohen në Buxhetin e Shtetit. Sipas Ligjit për taksat kombëtare nr. 9975, datë 28 korrik 2008, ndryshuar, një pjesë e tatimit mbi të drejtën e rentës do të ndahet për secilën njësi të qeverisjes vendore ("NJQV") në proporcion me kontributin e tyre në prodhimin e brendshëm të naftës, gazit dhe minerareve. Cilësia dhe siguria e të dhënave, Standardet e Aplikuara të Kontabilitetit Dispozitat aktuale rregullatore në Shqipëri kërkojnë që subjektet e përfshira të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) ose Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (IAS), të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit për shpenzimet e kontabilitetit dhe raportimi ligjor . Standardet e Auditimit të Aplikuara Të gjitha subjektet, përfshirë shoqëritë aksionare pjesëmarrëse ("SHA") dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar ("SHPK") janë subjekt i auditimit ligjor, duke përjashtuar ato SHPK të klasifikuara si njësi më të vogël. LIGJ-in Nr.10 091, datë 5.3.2009 “PËR AUDITIMIN LIGJOR, ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË AUDITUESIT LIGJOR DHE TË KONTABILISTIT TË MIRATUAR” (ndryshuar me ligjin nr.10 297, datë 8.7.2010, nr. 47/2016, datë 28.4.2016, konkretisht. Neni 41, Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare (ndryshuar shkronja
--	---

	“c”, me ligjin nr. 47/2016, datë 28.4.2016) Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese: a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar; b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit; c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i - totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii - shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii - ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël. Sqarojmë se subjektet minerare që raportojnë në Raportin EITI janë përgjithësisht shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk plotësojnë kushtin që i detyron të auditojnë bilancet e tyre nga ekspert të pavarur. Niveli i ndarjes paraqitet në Shtojcën 1, 2, 3 të Raportit EITI 2017 – 2018. Afati kohor i të dhënave Raporti i EITI 2017 – 2018 është prodhuar konform Kontrates (21.12.2020) dhe publikuar në Janar 2021. Me gjithë vështirësitë e shkaktuara nga pandemia, mbyllja për një kohë të gjatë e të gjithë ekonomisë dhe jetës sociale (karantinës së gjatë) raporti EITI 2017 – 2018 u realizua me sukses. Koherenca e të dhënave Raporti EITI 2017 – 2018 ofron një vlerësim të procedurave të sigurimit të kryera në numrat e raportuara nga subjektet qeveritare dhe të licencuarit në këtë raport. Kapitulli 10, jep detajet e harmonizimit të flukseve për vitin 2017 – 2018 dhe liston të gjitha subjektet që nuk raportojnë në 2017 – 2018, duke përfshirë publikimin e ndikimit bazuar në raportimin e njëanshëm nga njësitë qeveritare. Rekomandimet për përmirësime janë gjithashtu të listuara në Raportin EITI 2017 – 2018. Sekretariati EITI Shqipëri po harton një plan
--	--

	veprimi për ndjekjen e Rekomandimeve të Raportit EITI 2017 – 2018 dhe me miratimin e MSG të gjitha kërkesat do të mbulohen për të përmirësuar raportimin EITI në Shqipëri.
KËRKESA EITI 5 Shpërndarja e të ardhurave 5.1 Shpërndarja e të ardhurave të industrisë nxjerrëse 5.2 Transferta në nivel kombëtar 5.3 Manaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve	Shpërndarja e të ardhurave nga industria nxjerrëse Në Industrinë nxjerrëse si të gjitha degët e ekonomisë zbatohet Ligji për taksat kombëtare nr. 9975, datë 28 Korrik 2008, ndryshuar, ku të ardhurat grumbullohen nga shteti dhe shpërndahen, konform ligjit. E veçantë për industrinë nxjerrëse është taksa mbi rentën minerare, ku një pjesë e saj iu kalon Njërive të qeverisjes vendore (NJQV) në të cilat zhvillohet ky aktivitet. Në vite Kuadri ligjor për transferta lokale të rentës minerare ka pësuar ndryshime. Më 27 Nëntor 2014, Qeveria Shqiptare bëri disa përmirësime në Ligjin për Taksat Kombëtare, ku NJQV-të përfitojnë 5% të rentës së gjeneruar nga shitjet e naftës dhe mineraleve të nxjerra në NJQV pa asnjë kushtëzim. Drejtoritë rajonale të taksave dhe doganave duhet të dorëzojnë listën analitike të NJQV-ve të mbledhura dhe të përfituara nga reduktimi i të ardhurave në Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Financave ("MF"). Pas marrjes së rakordimit, MF fillon transferimet mujore të rentës të autorizuara në NJQV. (Ky ligj zbatohet edhe sot). Gjatë vitit 2019 – 2020 Alb-EITI në bashkëpunim me OSBE organizuan një sërë takimesh në Njësitë vendore, ku industria nxjerrëse ka aktivitet mbi përfitimet që kanë këto komunitete nga kjo industri dhe problematika që lidhen me aktivitetet e tyre. Ky aktivitet u kurorëzua me një takim kombëtar ku doli një dokument me propozimin konkret. Qeveria shqiptare po shqyrton kërkesat e njërive vendore me aktivitet në Industrinë nxjerrëse ku problemi kryesor është rritja e përqindjes së rentës që do të transferohet në NJQV. Transferta në nivel kombëtar Ministria e Financave dhe Ekonomisë është në proces përmirësimi të procedurave në mënyrë që të sigurohet për saktësinë dhe plotësinë e shpërndarjes së rentës në përputhje me kërkesat e reja ligjore. Manaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve Të ardhurat e mbledhura nga Buxheti Shtetit nga industria nxjerrëse bashkohen me të ardhurat e tjera në buxhet dhe alokohen natyrshëm nëpër

	zërat e buxhetit. Nuk ka alokim specifik të këtyre të ardhurave në programe të buxhetit me përjashtim të Rentës Minerare ku 5% i kalon pushtetit vendor sipas zonave ku ushtron aktivitetet industria nxjerrëse. AKBN menaxhon vetë një pjesë të të ardhurave nga Marrëveshjet Hidrokarbure. Deri tani AKBN nuk ka dhënë informacion se si alokohen këto të ardhura në buxhetin e saj. Shteti shqiptar mbledh të ardhura nga sektori i naftës dhe gazit nëpërmjet ndarjes së prodhimit të naftës, bonuset, rentën minerare, tatimit mbi fitimin dhe dividend, të ardhura nga punësimi. Në raport tregohet shpërndarja e të ardhurave totale të gjeneruara nga operacionet e naftës midis Qeverisë Shqiptare, shoqërisë Albpetrol, AKBN-së dhe shoqërive private të naftës. Interesi i Shtetit Shqiptar në PSA administrohet nga Albpetrol dhe AKBN, të cilat marrin nga PSA-të: bonuse, pjesë nga prodhimi i naftës dhe të ardhurave të tjera që rrjedhin nga mos-zbatimi i termave të kontratave si gjoba dhe garanci të ekzekutuara. MIE publikon informacion financiar lidhur me shpenzimet sipas natyrës dhe programit në faqen e saj të internetit http://infrastruktura.gov.al/.
KËRKESA EITI 6 Shpenzimet sociale dhe ekonomike 6.1 Shpenzimet sociale nga kompanitë nxjerrëse 6.2 Shpenzimet fiskale 6.3 Kontributi i sektorit nxjerrës në ekonomi	Shpenzimet sociale janë shpenzime materiale të bëra nga kompanitë në sektorin e Industrive Nxjerrëse në dobi të publikut dhe shoqërisë civile, siç është mandatar me ligj ose me kontratën me qeverinë. Qeveria dhe kompanitë e naftës të përfshira në sektorin e naftës informuan se aktualisht Marrëveshjet në fuqi të naftës nuk përfshijnë pagesa sociale të detyrueshme që duhet të kryhen nga kompanitë e naftës në dobi të komuniteteve. Koha dhe shuma e pagesave sociale vendosen nga kompanitë e naftës në diskrecionin e tyre. Shoqëritë duhet t'i paraqesin këto shpenzime për AKBN/Albpetrol për miratim si pjesë e miratimit vjetor të buxhetit. Shpenzimet fiskale MSG Shqipëri diskutoi në takimin e datës 12.02.2019 ekzistencën e “shpenzimeve quasi-fiskale” në Shqipëri dhe materialitetin e tyre. Deklarata e MSG për këtë çështje Në përputhje me kërkesën 6.2 të Standardit EITI, MSG- EITI Shqipëri u shpreh se janë dakord me përkufizimin që ka bërë Administratori i Pavarur në Raportin EITI në lidhje me Shpenzimet quasi-fiskale dhe

	se ligji dhe rregulloret që rregullojnë veprimtarinë e Albpetrol SH.A. nuk përfshijnë këto lloj shpenzimesh. MSG-ja EITI Shqipëri gjithashtu, u shpreh se kuadri ligjor shqiptar nuk parashikon ndonjë detyrim për “shpenzimet quasi-fiskale” as për kompanitë; e licencuara që kryejnë aktivitetet në industrinë nxjerrëse në Shqipëri. Kontributi i sektorit nxjerrës në ekonomi Bazuar në të dhënat e raportuara nga agjencitë qeveritare të paraqitura në Raportin e EITI 2017 – 2018, sektori nxjerrës dhe hidroenergji llogariten së bashku përkatësisht për vitin 2017, 5.1% të prodhimit të brendshëm bruto në 78,504 milionë lekë dhe për vitin 2018 6.1% të prodhimit të brendshëm bruto në shumën 100,534 milionë lekë. Eksportet nga sektori nxjerrës j llogariten përkatësisht për vitin 2017, 15 % të totalit të eksporteve në Shumen 44 miliard lekë dhe për vitin 2018, 18% të totalit të eksporteve në shumën 51 miliard lekë. Bazuar në të dhënat e raportuara nga DPT, kompanitë që operojnë në industritë nxjerrëse dhe të energjisë kishin mbi 40,000 të punësuar përkatësisht për secilin vit 2017 dhe 2018.
KËRKESA EITI 7 Rezultatet dhe ndikimi 7.1 Debat publik 7.2 Aksesueshmëria e të dhënave 7.3 Mospërputhjet dhe rekomandimet nga Raportet EITI 7.4 Shqyrtimi i rezultateve dhe ndikimin e zbatimit të EITI	Debat publik Raporti EITI në Shqipëri është i kuptueshëm dhe i aksesueshëm publikisht. Të dyja Raportet EITI dhe Skeda e Përmbledhjes së të Dhënave janë në dispozicion në format të hapur të të dhënave. Gjithashtu, kopjet e raporteve EITI prodhohen vazhdimisht dhe u shpërndahen palëve të interesuara. Raportet publikohen në faqen e internetit www.albeiti.org në gjuhën shqipe dhe angleze. Raporti i EITI Shqipëri është përdorur gjerësisht nga palët e interesuara në debate publike. Organizimi i takimeve me gazetarët nga mediat vendore dhe kombëtare, edicionet, shkrimet kronike dhe organizimi i takimeve me grupet e interesit vendore dhe të huaja, tregojnë qartë angazhimin e MSG dhe Sekretariatit Kombëtar EITI për të nxitur një debat publik mbarëkombëtar dhe për të ndikuar në zhvillimin ekonomik dhe social të komuniteteve. Aksesueshmëria e të dhënave Sekretariati Kombëtar EITI publikon raportet e EITI në faqen e saj të internetit dhe të gjitha palët e interesuara kanë qasje të plotë për të dhënat e kërkuara. Kopjet fizike të Raporteve EITI dhe Raporteve Përmbledhëse shpërndahen gjerësisht

	tek palët relevante të interesit. Në Dhjetor 2020 AlbEITI realizoi ngritjen e Open Data Portal me të dhëna nga industria nxjerrëse, i cili është i aksesueshëm nga të gjithë. Mospërputhjet dhe rekomandimet nga Raportet EITI Mospërputhjet dhe rekomandimet në Raportet EITI diskutohen në mbledhjet e MSG. Sekretariati Kombëtar propozoi që brenda MSG të krijohej një nëngrup i përhershëm. Ky grup do të ndjekë zbatimin e rekomandimeve të Raportit EITI dhe gjithashtu veprimet korrigjuese të ngritura nga Validimi deri në përmbushjen e tyre të plotë. Shqyrtimi i rezultateve dhe ndikimin e zbatimit të EITI Viti 2020 ka qenë një vit i vështirë, kushtëzuar nga pandemia e cila diktoi mbylljen e shume aktiviteteve për shkak të karantinës. Për të kapërcyer pengesat që dolën në këtë drejtim, Sekretariati Kombëtar EITI dhe MSG kanë punuar ngushtë me palët e përfshira në proces. Shumë nga aktivitetet e komunikimit dhe promovimit me të gjithë aktorët u kryen nga Sekretariati Kombëtar EITI dhe MSG. Miratimi i Ligjit për Transparencën është premtues, por në të njëjtën kohë kërkon koordinim të punës nga palët e përfshira. 2020 ishte viti i publikimit të Pronarëve Përfitues ku si anëtar i EITI, Shqipëria miratoi një ligj të posaçëm për të përmbushur këtë detyrim global. Një udhërrëfyes i Pronarëve Përfitues për të gjitha hapat që duhen ndjekur është botuar në Janar 2017. Sekretariati Kombëtar i EITI ka kryer dhe po kryen të gjitha aktivitetet e parashikuara në këtë udhërrëfyes. Shumë takime janë kryer nga Sekretariati Kombëtar i EITI dhe kohët e fundit nga OShC-të, anëtarët e MSG-së, me Njësitë e Qeverisjes Vendore në fushat ku operojnë industrinë nxjerrëse, kompanitë dhe përfaqësuesit e shoqërive civile, për të promovuar EITI dhe Raportimin EITI. Nga ana tjetër, janë organizuar takimeve me gazetarë nga media kombëtare dhe lokale. Informimi i medias mbi punën dhe misionin e iniciativave EITI është një rrugë që pasqyron një angazhim serioz për transparencën në sektorin nxjerrës. Risia që solli organizimi i Anketimi EITI ishte
--	--

	për Sekretariatit Kombëtar EITI mënyra më e mirë për të analizuar perceptimin e publikut për ndikimin dhe zbatimin e EITI në Shqipëri. Rezultatet e sondazhit treguan se administrata lokale dhe qendrore (e prekur nga raportimi EITI) nuk kishin informacion mbi kërkesat e EITI. Si rezultat, Sekretariati Kombëtar i EITI vendosi që aktivitetet e parashikuara në Planin e Punës do të luanin një rol kyç në organizimin e aktiviteteve informuese kryesisht duke u fokusuar në këtë grup. Mund të shprehim se qeveria vendore (kur operon industria nxjerrëse) dhe administrata qendrore duke iu përgjigjur me kohë dhe me cilësi kërkesave dhe detyrimeve të Nismës EITI dëshmon që Plani i Punës EITI ka arritur objektivin në këtë drejtim. Rritja progresive e kompanive raportuese në EITI Gjatë viteve, përqindja e raportimit nga kompanitë nxjerrëse u rrit në mënyrë progresive, duke synuar një përfshirje më të madhe të të tre sektorëve.
--	---

❖ VEPRIMTARIA E ALBEITI NË KUADËR TË REALIZIMIT TË RAPORTEVE EITI

Pas takimit të realizuar nga Albeiti në Sekretariatit Ndërkombëtar EITI në Oslo në janar të vitit 2023 u sugjerua që të mundësohej publikimi i raporteve për tre vite të njëpasnjëshme dhe konkretisht për vitet 2019-2020-2021. Këto raporte do të realizoheshin në përputhje me standardin e vitit 2019 të EITI. Dhe nga ana tjetër që në fillim të vitit 2023 i paraprimë procesit të realizimit të Raporteve EITI duke filluar që të mbledhim të gjitha informacionet e kërkuara paçka se nuk kishim marrë akoma ndonjë financim për këtë proces dhe paralelisht shtuam edhe vitin 2021 në procesin e realizimit të këtyre raporteve duke përfshirë në total 3 vite raportimi.

Bazuar mbi Standardin EITI të vitit 2019 Bordi Ndërkombëtar EITI ka vendosur që Raportet EITI mund të realizohen edhe në mënyrë të njëanshme nga institucionet shtetërore për ta lehtësuar procesin e realizimit të tyre si detyrim për çdo shtet dhe për rrjedhojë në mbledhjen e MSG të Albeiti është pranuar që edhe shteti shqiptar ti realizojë ato duke mbledhur vetëm të dhënat e marra nga institucionet shtetërore. Kjo është edhe falë besimit që ofron legjislacioni shqiptar që të dhënat e institucioneve shtetërore janë të sakta dhe të mjaftueshme për të realizuar Raportet EITI. Pra e thënë ndryshe institucionet përgjegjëse për raportim në kuadrin e realizimit të Raporteve të Transparencës 2019-2020-2021 përfshijnë, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, Enti Rregullator i Energjisë (ERE), Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Albpetrol sh.a., QKB, INSTAT, Njësitë e Qeverisjes Vendore, ku operon industria nxjerrëse.

Administratori i Pavarur, u kontraktua nga Albeiti me miratimin e Bankës Botërore në 11 tetor 2023 dhe filloi punën për realizimin e Raporteve EITI për vitet fiskale 2019, 2020 dhe 2021 përzgjedhur me tender të hapur kombëtar.

Aktualisht institucioni ynë në përputhje me ligjin është organi kompetent shtetëror që ka detyrimin për kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave të nevojshme për publikimin e Raporteve EITI 2019, 2020 dhe 2021 me kompaninë (Administrator i Pavarur) e cila në muajin tetor 2023 filloi punën që përgatisë këto raporte për llogarinë tonë.

Në kuadër të zbatimit të Projektit “Mbështetje për Procesin e Projektit të Nismës së Transparencës të Industrive Nxjerrëse (EITI) në Shqipëri”, i cili financohet nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve të Grantit Nr. TF 0B9998, të akorduar nga Fondi i Mirëbesimit me shumë donatorë, Qeveria Shqiptare miratoi edhe VKM Nr.756, datë 20.12.2023, “Për miratimin e letërmarrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të akorduar nga Fondi i Mirëbesimit me Shumë Donatorë, për financimin e projektit Mbështetje për procesin e projektit të nismës së transparencës së industrive nxjerrëse në Shqipëri”.

Referuar Standardit EITI-2019, Raportet EITI 2019, 2020 dhe 2021 do të mbulojnë sektorët e hidrokarbureve, minierave, hidroenergjisë dhe energjive të rinovueshme. Ky angazhim vjen edhe në kuadër të përpjekjeve të Shqipërisë për anëtarësim në BE, direktiva CBCR e BE për transparencë të plotë fiskale të sektorit dhe është tejet i monitoruar nga partnerët ndërkombëtarë dhe grupet e interesit.

Realizmi i Raporteve EITI në Shqipëri është i lidhur edhe me një bazë ligjore specifike dhe konkretisht me:

- Ligjin 10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në RSH” në nenin 36 pika 25 parashikon se: *Në kuadër të nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse, subjektet duhet: a)të raportojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore që hartohen sipas detyrimeve të përcaktuara në nismën për transparencë në industrinë nxjerrëse; b)forma e raportit teknik, financiar apo të pagesave të taksave duhet të jetë në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare për industrinë nxjerrëse; c)veprimtaria minerare e subjekteve minerare në Shqipëri dhe veprimet e tyre financiare me kompanitë mëma ose bija jashtë shtetit duhet të kryhen në përputhje me vlerat e kostove ose me një fitim të arsyeshëm të paracaktuar në programet e tyre të veprimtarisë minerare.*

<https://www.albeiti.org/site/ep-content/uploads/2021/06/Liqji-per-minierat-Nr.-10304-date-15.7.2010.pdf>

- Neni 51 pika 3 të Ligjit Nr. 10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në RSH” që parashikon se: Të dhënat për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare nuk quhen konfidenciale. Ato janë të hapura për publikun, në kuadër të nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse. Niveli i konfidencialitetit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

<https://www.albeiti.org/site/ep-content/uploads/2021/06/Liqji-per-minierat-Nr.-10304-date-15.7.2010.pdf>

- Ligjin Nr. 19/2015 datë 25.03.2015, “Për hidrokarburet në RSH” që parashikon se: “Në kuadër të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), kontraktorët që kanë lidhur marrëveshje hidrokarbure, organet e administratës tatimore dhe doganore, si dhe organet e qeverisjes qendrore dhe vendore kanë detyrimin të raportojnë, sipas standardit të caktuar nga kjo Nismë, pranë Sekretariatit të Nismës për Transparencë në Industrinë nxjerrëse, në përputhje

me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore që hartohen sipas detyrimeve të përcaktuara në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse publikon të dhënat sipas standardit EITI”.

<https://www.albeiti.org/site/ep-content/uploads/2021/06/Ligji-per-hidrokarburet-Nr-7746-date-28-7-1993.pdf>

- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.233 datë 23.03.2011 për “Miratimin e formës së raporteve, të mënyrës së botimit të të dhënave për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisë” parashikon gjithashtu detyrimin dhe mënyrën se si realizohet raportimi nga ana e institucioneve shtetërore.

https://www.albeiti.org/ep-content/uploads/2014/04/vkm_nr.233_date_23.3.2011_eiti.pdf

- VKM nr. 993 datë 09.12.15 “Për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Kombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI Shqipëri), në kuadër të anëtarësimit në organizimin ndërkombëtar EITI”, përcakton gjithashtu detyrimin e shtetit shqiptar dhe institucioneve përgjegjëse shtetërore që përmes Sekretariatit të punojë për të realizuar raportet e transparencës në kohë dhe me cilësi.

<https://www.albeiti.org/ep-content/uploads/2014/04/VKM-nr.-993-date-09.12.15-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-Sekretariatit-Kombetar-te-Nismes-per-Transparencene-Industrine-Nxjerrrese-EITI-Shqiperi.pdf>

- Ligjin Nr. 10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në RSH” në nenin 36 pika 25 që parashikon se: Në kuadër të nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse, subjektet duhet: a) të raportojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore që hartohen sipas detyrimeve të përcaktuara në nismën për transparencë në industrinë nxjerrëse; b) forma e raportit teknik, financiar apo të pagesave të taksave duhet të jetë në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare për industrinë nxjerrëse; c) veprimtaria minerare e subjekteve minerare në Shqipëri dhe veprimet e tyre financiare me kompanitë mëma ose bija jashtë shtetit duhet të kryhen në përputhje me vlerat e kostove ose me një fitim të arsyeshëm të paracaktuar në programet e tyre të veprimtarisë minerare. Në funksion të veprimtarisë së saj, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë informacion nga subjektet zotëruese të lejeve minerare, organet e administratës tatimore e doganore dhe organet e qeverisjes vendore, si dhe të publikojë në raportin vjetor të dhëna që kanë të bëjnë me pagesat e detyrimeve fiskale, të kryera nga subjektet minerare.

❖ **NDONJË PIKË E FORTË OSE DOBËSITË E IDENTIFIKUAR NË PROCESIN EITI**

Pikat e forta:

- a) *Një nga pikat e forta të EITI-t në Shqipëri është eksperiencia e krijuar tashmë ndër vite në implementimin serioz në këtë proces si nga ana e MSG-së ashtu edhe nga ana e stafit të Sekretariatit Kombëtar.*
- b) *Gjithashtu për tu përmendur si një pikë e fortë e këtij procesi është bashkëpunimi i shkëlqyer i të gjithë aktorëve të përfshirë në proces (kërkesa 7.4(a)(v)).*

Pikat e dobëta:

- a) *Ndërkohë që pikë e dobët e këtij procesi ngelet mosbërja e fondeve të nevojshme në mënyrë të vazhdueshme gjë e cila ka sjellë vazhdimisht problem në procesin e implementimit dhe që në vitin 2023 çoj dhe në pezullimin e Shqipërisë për shkak të mos publikimit të Raporteve EITI brenda afateve të caktuara.*

❖ **PUBLIKIMI I PRONARËVE PËRFITUES**

Në zbatim të kërkesës 7.4(a)(vi)) të Standardit EITI Shqipëria ka miratuar Ligjin Nr. 112/2020, “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”. Ky ligj zbatohet për subjektet raportuese, personat juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë. “Regjistri i Pronarëve Përfitues” është një bazë të dhënash elektronike shtetërore, në të cilin regjistrohen të dhënat e pronarëve përfitues të subjekteve që kanë detyrimin e raportimit të tyre, që mbledh në kohë reale të dhënat e regjistruara në regjistrat respektivë shtetërorë të administruara nga institucionet shtetërore përkatëse, si dhe shërben si arkiv elektronik zyrtar dhe siguron transparencën në fushën e pronarëve përfitues.

Regjistri i Pronarëve Përfitues administrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit, e cila është përgjegjëse: a) të regjistrojë, të administrojë, të përpunojë dhe të ruajë në regjistër të dhënat e deklaruara nga subjektet raportuese; b) të mundësojë disponueshmërinë e të dhënave të Regjistrit, në përputhje me nenin 7 të këtij ligji; c) të lëshojë ekstrakte për të dhënat e regjistruara në regjistër; ç) të ndërmarrë veprime të tjera në përputhje me këtë ligj. Për të gjithë të interesuarit informacioni mbi Pronarët Përfitues mund të merret në linkun më poshtë:

<https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-e-pronareve-perfitues-rpp/k%C3%ABrko-p%C3%ABr-subjekt-raportues/>

Ligji për Pronarët Përfitues është i publikuar në faqen zyrtare të Sekretariatit Kombëtar EITI. Gjithashtu në Planin e vet të Punës EITI Shqipëri ka parashikuar një aktivitet për vlerësimin e impaktit të Ligjit për Pronarët Përfitues. Për shkak të mungesës së fondeve deri në fund të vitit 2023 nuk u bë e mundur kryerja e këtij aktiviteti por është shtyrë që të fillojë në vitin 2024.

❖ KOSTOJA TOTALE E IMPLEMENTIMIT

Gjatë vitit 2023, Sekretariati Kombëtar EITI Shqipëri është financuar me fonde nga Buxheti i Shtetit. Konkretisht, plani i miratuar në fillim të vitit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka qenë 14.000.000 lekë, për periudhën Janar-Dhjetor 2023. Në muajin Dhjetor 2023, për shkak të nevojave për fonde shtesë dhe likuidimin e detyrimeve brenda afateve ligjore, në vijim të Aktit Normativ nr.6, datë 14.12.2023, për institucionin tonë janë miratuar 2.500.000 lekë shtesë në buxhet. Këto fonde janë përdorur për të përballuar shpenzimet e pagave të personelit, sigurimet shoqërore, si dhe shpenzimet operative, si më poshtë:

Buxheti i Miratuar	
Buxheti në fillim të vitit	14,000,000
Shtesa gjatë vitit	2,500,000
Pakësime gjatë vitit	-
Buxheti në fund të vitit	16,500,000
Shpenzime të realizuara	
Paga	9,639,816
Sigurime Shoqërore	1,603,356
Shpenzime Operative	5,256,759
Total Shpenzime	16,499,931
Përqindja e realizimit të buxhetit	100%

Në muajin Dhjetor 2023, ka hyrë në fuqi struktura e re organike e institucionit, e cila ka të miratuar 9 pozicione pune, nga të cilat në fund të vitit 2023 kanë qenë të plotësuar 5 pozicione.

❖ DETAJET E ANËTARËSISË DHE TAKIMET E MSG-SË GJATË VITIT 2022

Gjatë vitit 2023, janë zhvilluar vetëm 2 mbledhje MSG-je. Detajet për çështjet e diskutuara në këto takime, Axhenda dhe Minutat e Takimit janë të publikuara në linkun më poshtë:

<https://www.albeiti.org/site/viti-2023/>

Aprovuar nga
MSG:

Datë:
